



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.101

2 gusht

2010

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.503, datë 23.6.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.151, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave “Për statusin “Dëshmor i Atdheut””, të ndryshuar 5259
Vendim i KM nr.504, datë 23.6.2010	Për rishpërndarje fondesh, për shpenzime korente, ndërmjet programeve, brenda buxhetit të vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë 5259
Vendim i KM nr.505, datë 30.6.2010	Për përcaktimin e autoriteteve dhe të përgjegjësive, për menaxhimin e decentralizuar të asistencës së Bashkimit Europian, në kuadër të Instrumentit të Paraaderimit (IPA), komponenti III, zhvillimi rajonal, dhe komponenti IV, zhvillimi i burimeve njerëzore 5260
Vendim i KM nr.506, datë 30.6.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.71, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2010, në njësitë e qeverisjes qendrore”, të ndryshuar 5262
Vendim i KM nr.509, datë 30.6.2010	Për dhënie fondi, në buxhetin e vitit 2010, për komunën Finiq 5265
Vendim i KM nr.510, datë 30.6.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Ura e Gajdarit-Rrap” (ruga hyrëse, Sarandë) 5265
Vendim i KM nr.511, datë 30.6.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të përdorura, Korçë 5268

Vendim i KM nr.515, datë 30.6.2010	Për hapjen e programeve të studimeve të ciklit të parë në Universitetin e Sporteve të Tiranës	5269
Vendim i KM nr.516, datë 30.6.2010	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë në universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastër	5270
Vendim i KM nr.517, datë 30.6.2010	Për hapjen e programeve të studimeve të ciklit të parë në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan	5270
Vendim i KM nr.625, datë 28.7.2010	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.862, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për unifikimin e procedurave të kontrolit të territorit, nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar i ai vendor”	5271

VENDIM
Nr.503, datë 23.6.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.151, DATË 25.4.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STATUSIN “DËSHMOR I ATDHEUT””, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8607, datë 27.4.2002 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shkronjën “a” të pikës 1 të vendimit nr.151, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, emërtimi “Ministri i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin” zëvendësohet me “Ministri i Mbrojtjes”.
2. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.504, datë 23.6.2010

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH, PËR SHPENZIME KORENTE, NDËRMJET
PROGRAMEVE, BRENDA BUXHETIT TË VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
DREJTËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 16 të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve, për shpenzime korente, ndërmjet programeve, brenda buxhetit të vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, si më poshtë vijon:
 - a) Programit “Planifikim, menaxhim dhe administrim” t’i shtohet fondi 13 500 000 (trembëdhjetë milionë e pesëqind mijë) lekë.
 - b) Programit të Publikimeve Zyrtare t’i pakësohet fondi 500 000 (pesëqind mijë) lekë.
 - c) Programit të Sistemit të Burgjeve t’i pakësohet fondi 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë.
 - ç) Programit të Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor t’i pakësohet fondi 2 000 000 (dy milionë) lekë.
 - d) Programit të Shërbimit për Çështjet e Birësimeve t’i pakësohet fondi 1 000 000 (një milion) lekë.
 - dh) Programit të Shërbimit të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme t’i pakësohet fondi 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.
 - e) Programit të Shërbimit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave t’i pakësohet fondi 2 000 000 (dy milionë) lekë.
 - ë) Programit të Shërbimit të Provës t’i pakësohet fondi 3 000 000 (tre milionë) lekë.
2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.505, datë 30.6.2010

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETEVE DHE TË PËRGJEGJËSIVE, PËR MENAXHIMIN E
DECENTRALIZUAR TË ASISTENCËS SË BASHKIMIT EUROPIAN, NË KUADËR TË
INSTRUMENTIT TË PARAADERIMIT (IPA), KOMPONENTI III, ZHVILLIMI RAJONAL,
DHE KOMPONENTI IV, ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6 e 8 të ligjit nr.9840, datë 10.12.2007 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)”, me propozimin e Ministrit të Integritit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoritetet dhe strukturat përgjegjëse për menaxhimin e decentralizuar të asistencës së Bashkimit European, në kuadër të Instrumentit të Paraaderimit (IPA) për secilin nga komponentët, III, zhvillimi rajonal, dhe IV, zhvillimi i burimeve njerëzore, janë, si më poshtë vijon:

- a) Koordinatori strategjik (KS/SC);
- b) Struktura operative (SO/OS);
- c) Njësitë e zbatimit të programeve (NJZP/PIU);
- ç) Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktive (CFCU).

1.1 Koordinatori strategjik

a) Koordinatori strategjik (KS/SC) është autoriteti i menaxhimit të decentralizuar të IPA-s, për komponentët, zhvillimi rajonal dhe zhvillimi i burimeve njerëzore, nën përgjegjësinë e koordinatorit kombëtar të IPA-s (KKIPA/NIPAC).

b) Koordinator strategjik (KS/SC) është Ministria e Integritit dhe përfaqësohet nga një zyrtar i lartë, i cili caktohet me urdhër të brendshëm të Ministrit të Integritit (KKIPA/NIPAC);

c) KS/SC-ja është përgjegjës:

- për të siguruar bashkërendimin e komponentit të zhvillimit rajonal dhe të komponentit të zhvillimit të burimeve njerëzore;

- për të koordinuar asistencën e Bashkimit European, në kuadër të komponentit të zhvillimit rajonal dhe komponentit të zhvillimit të burimeve njerëzore;

- për të koordinuar hartimin e kuadrit strategjik koherent, siç përcaktohet në nenin 154 të rregullores zbatuese të IPA-së;

- për të koordinuar hartimin e programeve operationale (PO/OP), për komponentët, zhvillimi rajonal dhe zhvillimi i burimeve njerëzore;

- për të siguruar bashkërendimin e punës ndërmjet strategjive sektoriale dhe programeve;

ç) KS/SC-ja bashkëpunon me Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj, në Këshillin e Ministrave, dhe institucionet e tjera relevante, në përmbushje të detyrave të tij sipas këtij vendimi.

1.2 Struktura operative për zbatimin e komponentit III, zhvillimi rajonal

a) Struktura operative për zbatimin e komponentit III, zhvillimi rajonal, (SO/OS) është përgjegjëse për menaxhimin dhe zbatimin e programeve të IPA-s, në përputhje me parimet e menaxhimit të qëndrueshëm financiar.

b) SO/OS-ja ka në përbërje përfaqësues nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe institucioni tenderues/kontraktues e pagues. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit është ministria drejtuese e SO/OS-së për zbatimin e komponentit III, zhvillimi rajonal, dhe është përgjegjës për:

- hartimin e programit operacional për komponentin e zhvillimit rajonal;

- identifikimin e listës treguese me projekte për t'u financuar nga komponenti i zhvillimit rajonal;

- sigurimin e bashkëpunimit dhe përfshirjen e ministrive në hartimin e programit operacional dhe identifikimin e përparësive në fushat e mbështetura nga komponenti i zhvillimit rajonal;

- sigurimin e dokumenteve të nevojshme për monitorimin e zbatimit të programeve;
c) Drejtuesi i SO/OS-së është një zyrtar i lartë, që caktohet me urdhër të brendshëm të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit.

ç) Për mbështetjen dhe menaxhimin e zbatimit të politikave të tri akseve që do të mbështeten nga komponenti III, në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës do të krijohen njësitë e zbatimit të programeve (NJZP/PIU).

d) Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës përcaktojnë, me urdhër të brendshëm, strukturat përgjegjëse në ministritë e tyre që do të funksionojnë si NJZP/PIU.

1.3 Struktura operative për zbatimin e komponentit IV, zhvillimi i burimeve njerëzore.

a) Struktura operative për zbatimin e komponentit IV, zhvillimi i burimeve njerëzore, (SO/OS) është përgjegjëse për menaxhimin dhe zbatimin e programeve, IPA, në përputhje me parimet e menaxhimit të qëndrueshëm financiar;

b) SO/OS-ja ka në përbërje përfaqësues nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucioni tenderues/kontraktues dhe i kryerjes së pagesave;

c) Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është ministria drejtuese e SO/OS-së për zbatimin e komponentit IV, zhvillimi i burimeve njerëzore, dhe është përgjegjës për:

- hartimin e programit operacional për komponentin e zhvillimit të burimeve njerëzore;

- sigurimin e bashkëpunimit dhe përfshirjen e ministrive relevante në hartimin e programit operacional dhe bashkëpunimin me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për identifikimin e përparësive në fushat e mbështetura nga komponenti i zhvillimit të burimeve njerëzore;

ç) Drejtuesi i SO/OS-së është një zyrtar i lartë, i cili caktohet me urdhër të brendshëm të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;

d) Për mbështetjen dhe menaxhimin e zbatimit të politikave të akseve kryesore që do të mbështeten nga komponenti IV, në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës do të krijohen njësitë e zbatimit të programeve (NJZP/PIU);

dh) Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës përcaktojnë me urdhër të brendshëm, strukturat përgjegjëse në ministritë e tyre që do të funksionojnë si NJZP/PIU.

2. Drejtuesit e SO/OS-ve përgjigjen përpara KS/SC-së për përmbushjen e detyrave të tyre sipas këtij vendimi.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve, në Ministrinë e Financave, (CFCU) do të jetë agjencia zbatuese (tenderuese/kontraktuese dhe e kryerjes së pagesave) për komponentët III dhe IV të IPA-s. Kjo drejtori do të kryejë të gjitha funksionet, sikurse përcaktohen në vendimin nr.719, datë 18.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve, ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së BE-së, në kuadër të IPA-s.” .

4. Ngarkohet Ministria e Integritetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.506, datë 30.6.2010

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.71, DATË 3.2.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOSSHME, PËR VITIN 2010, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr.71, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2010, në njësitë e qeverisjes qendrore është 1411 veta, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Përjashtimisht për qendrat e transferimit të teknologjisë në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për shkak të veçorisë së punës, pagesa e punonjësve të kontraktuar përllëgaritet sipas vëllimit të punës së kryer dhe përballohet vetëm nga të ardhurat e realizuara nga çdo qendër, brenda vitit 2010.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga shpenzimet korente, të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2010, të njëjtit të qeverisjes qendrore.

4. Ngarkohet Ministria e Financave ta miratojë me hollësi numrin e punonjësve sipas lidhjes nr.1, të përmendur në pikën 1, në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin nr.1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe veprimtarive sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e miratimit të tij.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Gr.	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare	Muajt
04	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	24			
	Aparati i Ministrisë	1	Sanitare	deri 3 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit	1	Operatore	deri 5 orë/ditë	vjetore
	Inspektorati Qendror Teknik	1	Sanitar	deri 3 orë/ditë	vjetore
	Inspektorati Qendror Teknik	1	Punëtorë mirëmbajtjeje në laborator	deri 5 orë/ditë	vjetore
	ALBINVEST	1	Sanitar	deri 3 orë/ditë	vjetore
	Shërbimi Gjeologjik	2	Punëtor shpimi	3-5 orë/ditë	vjetore
	Shërbimi Gjeologjik	1	Punëtor rilevimi	3-5 orë/ditë	vjetore
	Shërbimi Gjeologjik	11	Nëpunës roje	8 orë/ditë	5 muaj
	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë	5	Punëtorë	3-4 orë/ditë	7 muaj
05	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	201			
	QTTB në F.Krujë/Lushnjë/Shkodër/Vlorë/Korçë	175	Punëtorë blegtorie/fushe/mekanizator/roje e bazës eksperimentale		
	Ajencia Kombëtare e Duhan-Cigareve	12	Punëtor fushe	4 orë/ditë	Maj-dhjetor
	Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve	2	Teknikë	4 orë/ditë	Maj-dhjetor
	DBRUK	12	Punonjës dezinfektimi	8 orë/ditë	2 muaj
06	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit	502			
	ALUIZNI	500	Specialistë/ndihmëspecialistë	8 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Ujësjetllës-Kanalizimeve	1	Sanitar	deri 3 orë/ditë	vjetore
	IQT	1	Sanitar	deri 4 orë/ditë	vjetore
10	Ministria e Financave	28			
	Spektori i pagesave të dëmshpërblimeve	4	Specialiste	8 orë/ditë	6 muaj
	Spektori i pagesave të dëmshpërblimeve	1	Punonjës arkive	8 orë/ditë	6 muaj
	Drejtoria e Financimeve, Kontraktive/dega thesarit Tiranë	1	Roje	8 orë/ditë	6 muaj
	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktiveve	1	Sanitar	deri 3 orë/ditë	vjetore
	Degët e thesarit	7	Sanitar	deri 3 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	4	Operatore	deri 4 orë/ditë	vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Elbasan	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Morinë	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Shkodër	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Kakavijë Gjirokastër	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Vlorë	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Tiranë	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Tushemisht	1	Sanitare	3-4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Qafë-Thanë	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
	Dogana Tre-Urat Përmet	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	3-4 orë/ditë	vjetore
11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	401			
	Sistemi arsimor parauniversitar	41	Sanitare	4 orë/ditë	shtator/dhjetor
	Instituti i Arkeologjisë	360	Punonjës gjermimi	8 orë/ditë	1 muaj
12	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	10			
	ZAK Butrint	5	Ciceronë	8 orë /ditë	4.5 muaj
	ZAK Butrint	1	Punëtor mirëmbajtjeje	8 orë /ditë	4.5 muaj
	Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të parkut Arkeologjik Bylis	1	Vëzhgues/Ciceron	8 orë /ditë	korrik-shtator
	Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të parkut Arkeologjik Apoloni	1	Vëzhgues/Ciceron	8 orë /ditë	korrik-shtator
	Muzeu Kombëtar Gjergj Kastrioti Krujë	1	Vëzhgues/Ciceron	8 orë /ditë	korrik-shtator
	Muzeu Kombëtar Onufri dhe				

	Etnografik Berat	1	Vëzhgues/Ciceron	8 orë /ditë	korrik-shtator
13	Ministria e Shëndetësisë	6			
	Spitali Psikiatrik Elbasan	3	Kaldajistë	8 orë /ditë	4.5 muaj
	Drejtoria e Shëndetit Publik Vlorë	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	4 orë /ditë	Mars-dhjetor
	Drejtoria e Shëndetit Publik Peqin	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	4 orë /ditë	Mars-dhjetor
	Drejtoria e Shëndetit Publik Has	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	4 orë /ditë	Mars-dhjetor
15	Ministria e Jashtme	10			
	Aparati i Ministrisë	2	Punëtorë mirëmbajtjeje	6 orë /ditë	vjetore
	Spektori i legalizimeve	5	Preparatorë	6 orë /ditë	vjetore
	Spektori i arkivit	3	Arkivistë	6 orë /ditë	vjetore
16	Ministria e Brendshme	136			
	Aparati	1	Specialist përkthyes	8 orë/ditë	6 muaj
	Aparati	2	Teknikë	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e pushimit Durrës	2	Kuzhinier	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e pushimit Durrës	4	Ndihmëskuzhinier	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e pushimit Durrës	2	Kamarierë	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e pushimit Durrës	1	Punëtor restoranti	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e pushimit Durrës	4	Punëtore hoteli	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e pushimit Durrës	1	Receptionist	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e pushimit Durrës	1	Elektricitist	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e pushimit Durrës	1	Hidraulik	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e pushimit Durrës	1	Punëtor gjelbërimi	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e pushimit Durrës	1	Lavanderi	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e pushimit Durrës	4	Kuzhinier	8 orë/ditë	1 qershor-10 shtator
	Shtëpia e pushimit Durrës	4	Ndihmëskuzhinier	8 orë/ditë	1 qershor-10 shtator
	Shtëpia e pushimit Durrës	27	Kamerierë	8 orë/ditë	1 qershor-10 shtator
	Shtëpia e pushimit Durrës	7	Punëtore kuzhine	8 orë/ditë	1 qershor-10 shtator
	Shtëpia e pushimit Durrës	7	Punëtore restoranti	8 orë/ditë	1 qershor-10 shtator
	Shtëpia e pushimit Durrës	25	Punëtorë hoteli	8 orë/ditë	1 qershor-10 shtator
	Shtëpia e pushimit Durrës	3	Receptionist	8 orë/ditë	1 qershor-10 shtator
	Shtëpia e pushimit Durrës	1	Elektricitist	8 orë/ditë	1 qershor-10 shtator
	Shtëpia e pushimit Durrës	1	Hidraulik	8 orë/ditë	1 qershor-10 shtator
	Shtëpia e pushimit Durrës	2	Punëtor gjelbërimi	8 orë/ditë	1 qershor-10 shtator
	Shtëpia e pushimit Durrës	1	Lavanderi	8 orë/ditë	1 qershor-10 shtator
	Rezervat materiale të shtetit	20	Roje	8 orë/ditë	6 muaj
	Rezervat materiale të shtetit	5	Punëtorë magazine	8 orë/ditë	6 muaj
	Qendra e Formimit Policor	2	Sanitar	8 orë/ditë	5 muaj
	Qendra e Formimit Policor	2	Ndihmëskuzhinier	8 orë/ditë	5 muaj
	Qendra e Formimit Policor	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	5 orë/ditë	5 muaj
	Qendra e Formimit Policor	3	Kuzhinier	8 orë/ditë	5 muaj
18	Shërbimi Informativ i Shtetit	36			
	Shërbimi Informativ i Shtetit	5	Sanitar	3-4 orë/ditë	vjetore
	Shërbimi Informativ i Shtetit	1	Sanitar	3-4 orë/ditë	6 muaj
	Shërbimi Informativ i Shtetit	8	Kuzhinier	8 orë/ditë	3 muaj
	Shërbimi Informativ i Shtetit	4	Banakier	8 orë/ditë	3 muaj
	Shërbimi Informativ i Shtetit	18	Pastruese	8 orë/ditë	3 muaj
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	10			
	Aparati	10	Administratore dokumentesh	5 orë/ditë	vjetore
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	35			
	Aparati	4	Roje	8 orë/ditë	4 muaj
	Në institucionet e shtëpisë së foshnjës/fëmijëve/moshuarve/qendrat e zhvillimit/qendrat pritëse dhe ditore	21	Mjekë	deri 4 orë/ditë	vjetore
		10	Sanitar	deri 4 orë/ditë	vjetore
28	Prokuroria e Përgjithshme	9			
	Aparati	2	Përkthyes	5 orë/ditë	vjetore
	Prokuroria Tiranë	1	Punëtorë mirëmbajtjeje	4 orë/ditë	vjetore
	Prokuroria Durrës	1	Sanitar	3-4 orë/ditë	vjetore
	Prokuroria e Apelit për Krimet e Rënda	1	sanitar	3-4 orë/ditë	vjetore
	Aparati	4	Përkthyes	8 orë/ditë	4 muaj
63	Këshilli i Lartë i Drejtësisë	1			
	Aparati	1	Stenograf	5 orë/ditë	9 muaj
77	Autoriteti i Konkurrencës	2			
	Autoriteti i Konkurrencës	1	Teknik mirëmbajtjeje	5 orë/ditë	vjetore
	Autoriteti i Konkurrencës	1	Sanitar	3-4 orë/ditë	vjetore
	Total numri i punonjësve	1411			

VENDIM
Nr.509, datë 30.6.2010

PËR DHËNIE FONDI, NË BUXHETIN E VITIT 2010, PËR KOMUNËN FINIQ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komunës Finiq, në buxhetin e vitit 2010, t’i jepet fondi prej 10 919 223 (dhjetë milionë e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind e njëzet e tre) lekësh, për përballimin e detyrimeve doganore për tubacione dhe materiale të tjera, për ndërtimin e ujësjellësit.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe komuna Finiq për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.510, datë 30.6.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “URA E GAJDARIT - RRAP” (RRUGA HYRËSE, SARANDË)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Ura e Gajdarit - Rrap” (rruga hyrëse, Sarandë).
2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 1 049 (një mijë e dyzet e nëntë) m², tokë truall, me vlerë 12 588 000 (dymbëdhjetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë, objekte, me sipërfaqe 780.5 (shtatëqind e tetëdhjetë pikë pesë) m², me vlerë 14 262 761 (katërmëdhjetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë.
4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 475 000 (katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për tokë truall dhe objekte (dyqan, objekte banimi, karabina) është 26 850 761 (njëzet e gjashtë milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë, e cila do të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.
6. Shpronësimi të fillojë më 30.6.2010 dhe të përfundojë më 15.9.2010.

7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë të përditësuar, brenda afateve ligjore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Pasuria në emër të bashkëpronarëve Agim Dule, Avdul Dule dhe Musa Musai të kompensohet, pasi të ketë përfunduar procesi i regjistrimit të pasurisë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si dhe pasi këta bashkëpronarë të kenë paraqitur dokumentin hipotekor të pronës. Ndërsa pasuritë në emër të shtetasve Thanas Vaho Naci, Xhemal Resul Cepe dhe Sheko Mine Xhuvani do të kompensohen pasi të ketë përfunduar procesi i legalizimit të pasurive që ata disponojnë dhe pasi ata të kenë përfunduar regjistrimin e pasurive në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe të kenë paraqitur dokumentin hipotekor të pronës.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve sipas pikave 7 e 8 të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

10. Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Sarandë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, si dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

11. Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Sarandë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

12. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Sarandë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “URA E GAJDARIT RRAP-SARANDË”

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kad.	Nr. i pasurisë	Vërtetim hipotekor	Lloji i pasurisë					Sip. objekti m ²	Vlera totale lekë	Shënime
							Truall			Objekte				
							Sip.m ²	Çmimi lek/m ²	Vlera lekë	Lloji	Vlera lekë			
1	Agim Avdul Musa Musai		Dule Dule	1722			36	12000	432000	DYQAN	3775695	194	4207695	Proces.rregj.fillestar konf.Zrpp
2	Thanas	Vaho	Naci	8642	25/98		195	12000	2340000	BANESË	6151398	420	8491398	Prces legalizimi-konf
3	Sheko	Mine	Xhuvani	8642	25/99		110	12000	1320000	BANESË	3632855	107.5	4952855	Prces legalizimi-konf
4	Xhemal	Resul	Cepe	8642	25/97		220	12000	2640000	KARAB.IK	702813	59	3342813	Prces legalizimi-konf
5	Simon	Josif	Cipa	8642		138	200	12000	2400000				2400000	Konf.Zrpp (vërt.hip)
6	Ilmir	Subi	Majka	8642		1	99	12000	1188000				1188000	Konf.Zrpp (vërt.hip)
7	Veli	Fiko	Hasani	8642		14	107	12000	1284000				1284000	Konf.Zrpp (vërt.hip)
8	Artur	Baftjar	Myftari	1722	1814/1		82	12000	984000				984000	Konf.Zrpp (cert.prone)
	Totali						1049		12588000		14262761	780.5	26850761	

VENDIM
Nr.511, datë 30.6.2010

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I IMPIANTIT PËR
TRAJTIMIN E UJËRAVE TË PËRDORURA, KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (tokë truall), që preken nga ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të përdorura, Korçë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Ujësjiellës-Kanalizime, sh.a., Korçë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 434.5 (katërqind e tridhjetë e katër pikë pesë) m², tokë truall, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 4 345 000 (katër milionë e treqind e dyzet e pesë mijë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 252 500 (dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Ujësjiellës – Kanalizime, sh.a., Korçë.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 4 345 000 (katër milionë e treqind e dyzet e pesë mijë) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë”, e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 1.7.2010 dhe të përfundojë më 30.8.2010.

7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP-ja, Korçë”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Ujësjiellës – Kanalizime, sh.a.-së, Korçë.

8. Ujësjiellës Kanalizime, sh.a., Korçë, të kryejë likuidimin e pronarëve të pasurive, për të cilat janë bërë shënimet “Konfirmim nga ZRPP-ja, Korçë”, në bazë të dokumentacionit të pronësisë, brenda afateve të përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi.

9. Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Korçë, në bashkëpunim me Ujësjiellës – Kanalizime, sh.a., Korçë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojë procedurat për hedhjen e sipërfaqes së shpronësuar mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’i vihet në dispozicion nga Ujësjiellës-Kanalizime, sh.a., Korçë, si dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të shtetit.

10. Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Korçë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në çastin kur të realizohen procesi i hedhjes së sipërfaqes së objektit mbi hartën kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuar.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Ujësjiellës-Kanalizime, sh.a., Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
 DREJTORIA JURIDIKE
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

Nr.	Pronari			Nr. i pasurisë	Zona Kadastrës	Lloji i pasurisë	Sip. m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera lekë	
	Emri	Atësia	Mbiemri							
1	Vasil		Panariti	8/251	8561	Truall	166.2	10000	1 662 000	Konfirmim nga ZRPP Korçë
2	Nikolla	Ligor	Çeço	8/50	8561	Truall	268.3	10000	2 683 000	Konfirmim nga ZRPP Korçë
Totali lekë									4 345 000	

VENDIM
Nr.515, datë 30.6.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe të Rekreacionit, të Universitetit të Sporteve të Tiranës, të programit të studimit të ciklit të parë “Fushat e veprimtarisë fizike, të shëndetit dhe të rekreacionit”. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet “Diplomë e nivelit të parë”, DNP, në “Fushat e veprimtarisë fizike, të shëndetit dhe të rekreacionit”.

2. Hapjen, në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, të Universitetit të Sporteve të Tiranës, të programit të studimit të ciklit të parë “Shkenca të lëvizjes”, në bazë të riorganizimit të programit të studimit të ciklit të parë “Edukim fizik dhe sporte”. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë e nivelit të parë”, DNP, në “Shkencat e lëvizjes”.

3. Programet e studimeve të ciklit të parë realizohen me 180 kredite, ECTS dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 (tri) vite akademike.

4. Studentët, të cilët ndjekin studimet në programin e studimit “Edukim fizik dhe sporte”, në kohëzgjatjen normale, edhe pas daljes së këtij vendimi, e përfundojnë atë me të njëjtin emërtim të programit të studimit, për të cilin kanë filluar studimet. Studentët përsëritës i nënshtrohen programit të studimit të vitit akademik, në të cilin vazhdojnë studimet.

5. Programi i studimit “Fushat e veprimtarisë fizike, të shëndetit dhe të rekreacionit” të fillojë veprimtarinë e vet në vitin akademik 2010 – 2011.

6. Programi i studimit “Shkencat e lëvizjes” të fillojë veprimtarinë e vet në vitin akademik 2010 – 2011.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit të Sporteve të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Sporteve të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.516, datë 30.6.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË NË
UNIVERSITETIN “EQREM ÇABEJ”, GJIROKASTËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, të programeve të studimit të ciklit të parë:

- a) Fizikë dhe teknologji informacioni;
- b) Teknologji informacioni.

2. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në:

- a) Fizikë dhe teknologji informacioni;
- b) Teknologji informacioni.

3. Programet e studimit të ciklit të parë realizohen me 180 kredite, ECTS, dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 (tri) vite akademike.

4. Programet e studimit të ciklit të parë të fillojnë veprimtarinë në vitin akademik 2010–2011.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, pa efekte buxhetore shtesë.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.517, datë 30.6.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË NË
UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR XHUVANI”, ELBASAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, të programeve të studimeve të ciklit të parë:

- a) Gjuhë shqipe dhe frënge,
- b) Histori dhe gjuhë gjermane,
- c) Gjeografi dhe gjuhë italiane.

2. Në përfundim të këtyre programeve të studimeve lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP) në:

- a) Gjuhë shqipe dhe frënge,
 - b) Histori dhe gjuhë gjermane,
 - c) Gjeografi dhe gjuhë italiane.
3. Programet e studimeve të ciklit të parë realizohen me 180 kredite, ECTS, dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 (tri) vite akademike.
4. Programet e studimeve të ciklit të parë të fillojnë veprimtarinë në vitin akademik 2010-2011.
5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, pa efekte buxhetore shtesë.
6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.625, datë 28.7.2010

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR.862, DATË 5.12.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR UNIFIKIMIN E PROCEDURAVE TË KONTROLIT TË TERRITORIT, NGA INSPEKTORATI NDËRTIMOR E URBANISTIK KOMBËTAR I AI VENDOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.862, datë 5.12.2007, të Këshillit të Ministrave, bëhet ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë vijon:

1. Paragrafi i katërt, në pikën 14, ndryshohet, si më poshtë vijon:
“INUK-ja duhet të marrë vendimet përkatëse, brenda një afati 10-ditor nga data e mbarimit të afatit 15-ditor, të parashikuar në paragrafin e tretë të kësaj pike.”.
 2. Pas pikës 19 shtohet pika 20, me këtë përmbajtje:
“20. Formularët bashkëlidhur janë pjesë integrale e këtij vendimi.”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 2.8.2010

Doli nga shtypi më 2.8.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 16 lekë